

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Keshilli i Ministrave**

**VENDIM**  
**Nr. 854, date 17. 12. 2004**

*(ndryshuar me VKM nr. 13, datë 04.01.2012)*

**PER KRITERET DHE MASEN E PERFITIMIT TE PAGESES SE**  
**PAPUNESISE PER BASHKESHORTIN/EN E USHTARAKUT AKTIV TE**  
**FORCAVE TE ARMATOSURA**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 37 e 48, te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Bashkeshortit/es se ushtarakut aktiv (oficer, nenoficer, ushtar me pagese/profesionist) te Forcave te Armatosura t'i jepet page papunesie, sipas kriterëve dhe ne masen e percaktuar ne kete vendim, kur ushtaraku emerohet ne detyre jashte vendbanimit te perhershëm, brenda apo jashte vendit, si dhe kur ploteson keto kriterë:

a) Nderron vendbanim se bashku me familj en, te vertetuar me certifikaten familjare, per rastet e emerimit brenda vendit, a te vertetuar nga struktura ku sherben, per rastet e emerimit jashte vendit.

b) Bashkeshorti/ja humbet vendin e punes;

c) Ne vendbanimin e ri nuk ka mundesi punesimi;

ç) Nuk ushtron veprimtari fitimprurese;

d) Nuk trajtohet me ndihme ekonomike.

dh) Bashkeshorti/ja ka paguar rregullisht kontributet për sigurimet shoqërore deri në momentin e përfitimit të pagesës së papunësisë.<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Shtuar me VKM 13/2012

"1/1 Dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, përtërihet çdo vit nga vetë përfituesi dhe dorëzohet në strukturën ku përfiton këtë pagesë<sup>2</sup>".

2. Paga e papunesise jepet ne emer te bashkeshortit/es se papune ne qendren e punes se ushtarakut.

3. Masa e pageses te jete:

a) 100 per qind e pages minimale ne shkalle vendi, te miratuar nga Keshilli i Ministrave, kur bashkeshorti/ja e papune ka vjetersi pune mbi 1 deri ne 10 vjet.

b) 120 per qind e pages minimale ne shkalle vendi, te miratuar nga Keshilli i Ministrave, kur bashkeshorti/ja e papune ka vjetersi pune mbi 10 vjet.

Pagesa e papunesise ndryshon sa here ndryshon pagesa minimale ne shkalle vendi.

4. Bashkeshorti/ja e ushtarakut, per te perfituar pagesen e papunesise, duhet te paraqese kerkesen per pune ne zyrat e punes dhe te perkrahjes sociale dhe ne institucionin, ku sherben bashkeshorti ushtarak.

5. Ne rast refuzimi pa arsye te vendit te punes se ofruar nga institucionet e permendura ne piken 4 te ketij vendimi, sipas profesionit dhe specialitetit, perfituesit i nderpritet pagesa e papunesise.

6. Pages a e papunesise round te perfitohet per nje periudhe deri ne 7 vjet.

7. Bashkeshorti/ja e ushtarakut, qe ka perfituar sipas shkronjes "b", te pikes 3, te vendimit nr.86, date 12.3.1992, te Keshillit te Ministrave, "Per disa te drejta e detyrime te ushtarakeve, te cilat rrjedhin nga ligji nr.7496, date 3.7.1991, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", do te vazhdoje te perfitoje pagese papunesie, ne masen e perfituar ne mbeshtetje te vendimit nr.86, date 12.3.1992, edhe per 7 vjet, par jo me shume se 15 vjet dhe jo me te vogel se masa e percaktuar ne piken 3 te ketij vendimi.

8. Bashkeshorti/ja e ushtarakut, qe ka perfituar pagesen e papunesise e perfiton ate edhe pasi ushtaraku nxirret ne rezerve, ne lirim ose vdes, por jo me shume se periudha e caktuar ne piken 6 te ketij vendimi dhe

---

<sup>2</sup> Shtuar me VKM 13/2012

ne perputhje me kriteret e vendosura ne kete vendim. Ne cdo rast, raga e papunesise do te terhiqet ne strukturen ku eshte trajtuar financiarisht ushtaraku.

9. Pagesa e papunesise per bashkeshortin/en e ushtarakut, qe sherben jashte struktures organike te Forcave te Armatosura, te perballohet nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes.

10. Periudha e trajtimit me pagese papunesie sipas ketij vendimi njihet si vjetersi sigurimi, per efekt te perfitimit te pensionit te pleqerise, ne perputhje me ligjin "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise"

11. Kontributi per kete periudhe te derdhet ne emer te bashkeshortit/es perfituese, te llogaritur mbi masen konkrete te kontributit minimal, te caktuar nga Keshilli i Ministrave, dhe te perballohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe perfituesi.

Masa e kontributit per pension pasqyrohet ne listepagesat tip, te miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore.

12. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi, te perballohen nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqerore per zbatimin e ketij vendimi.

14. Shkronja "b", e pikes 3, te vendimit nr.86, date 12.3.1992, te Keshillit te Ministrave, "Per disa te drejta e detyrime te ushtarakeve, te cilat rrjedhin nga ligji nr.7496, date 3.7.1991, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.5.2004.

**KRYEMINISTRI  
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES  
PANDELI MAJKO**